



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 513/1 Prot

Tiranë, më 04.3.2024

Lënda: Në përgjigje të kërkesës tuaj

QENDRËS RES PUBLICA

Tiranë

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është depozituar kërkesa juaj për informacion administruar me tonën nr. 513 Prot., datë 20.02.2024 dhe regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të Zyrës së Komisionerit me nr. rendor 07, datë 20.02.2024.

Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit administroi 956 ankesa me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*" si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 48 procedurave të mbartura nga viti 2022 (gjithsej 1004 ankesa).

Referuar të dhënave, për aq sa mund të indentifikohen, ankesat e paraqitura janë grupuar në katër kategori, sipas grafikut të mëposhtëm.

	2023
Gazetarë	395
Qytetar	367
OSHC	171
Avokatë	23

Nga totali prej 1004 ankesash, për 609 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit është shprehur me 45 vendime për 46 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 41 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 3 vendime rrëzimi, dhe 1 vendim me sanksion administrativ.

Vendimet mund ti konsultoni në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit <https://www.idp.al/vendime-2023-ddi/>

Ndërkaq, 146 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit të cilat rezultojnë për çështje me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Gjithashtu, rezultojnë 22 ankesa të refuzuara, bazuar në kufizimet e LDI-së, 59 ankesa janë paraqitur jashtë afatit, 36 ishin të paplota, si dhe 86 të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2024.

Faleminderit,

KOORDINATORI

Alketa Koja

